

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Arjeta Sadiku dhe me procesmbajtësen Ganimete Hasani-Krasniqi, në konfliktin administrativ të paditëses Sh. N. nga fshati B., Komuna e P., kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale–Departamenti i Administratës Pensionale i Republikës së Kosovës, në Prishtinë, me bazë juridike, anulim i aktit administrativ, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në prani të paditëses, me datën 25 tetor 2016, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Sh. N. nga fshati B., Komuna e P..
- II. ANULOHET** vendimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)-Departamenti i Administratës Pensionale të Republikës së Kosovës (DAPRK) në Prishtinë, me numër të dosjes *numër i dosjes...* i datës **13.08.2014** dhe çështja i kthehet të paditurës në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m i

Paditësja me padinë e datës 14 janar 2015 dhe në seancën e shqyrtimit kryesor, ka kërkuar nga gjykata që të anulohet vendimi i MPMS-DAPRK nr. 5052818 i datës 13.08.2014, me të cilin i është refuzuar si e pabazuar ankesa për njohjen e të drejtës në pension të personave me aftësi të kufizuar. Pretendon se e paditura me vendimin e lartcekur në mënyrë të kundërligjshme ka vendosur lidhur me ankesën e paditëses, duke mos marr për bazë gjendjen shëndetësore të vet paditëses si dhe dokumentacionin mjekësor, në bazë të të cilit vërtetohet se paditësja nuk është e aftë për punë dhe si pasojë e gjendjes së saj shëndetësore, ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme mjekësore. Pohon se nga torturat e luftës së fundit në Kosovë, ka probleme të vazhdueshme me unazat e qafës për të cilat probleme i është rekomanduar të bëjë intervenim kirurgjik. Po ashtu thekson se është anëtare e shoqatës "H." për shkak të paaftësisë së saj. Thekson se pa bazë ligjore i është mohuar e drejta në këtë pension të cilin e ka shfrytëzuar për dy vite, sepse e njëjta ka të njëjtat probleme si më parë dhe se gjendja nuk i është përmirësuar fare, përkundrazi i është rënduar më shumë. Kërkon nga gjykata që të aprovoj padinë si të bazuar, ndërsa vendimin e të paditurës ta anulojë.

E paditura në përgjigjen në padi të datës 01.08.2016 e ka kundërshtuar në tërsi padinë e paditëses si të pabazuar. Ka theksuar se Këshilli i Ankesave për Pensione me Aftësi të Kufizuara në kuadër të të paditurës MPMS-DAPK, pasi shqyrtoi ankesën e paditëses, mori vendim me të cilin refuzoi ankesën, me arsyetimin se paditësja nuk i plotëson kushtet për të qenë shfrytëzuese e pensionit me aftësi të kufizuar të plotë dhe të përhershme, duke vërtetuar vendimin e Komisionit Mjekësor të shkallës së parë plotësisht si të bazuar konform Ligjit Nr. 2003/23. I propozon gjykatës që pas administrimit të provave ta refuzojë padinë e paditëses si të pabazuar, duke vërtetuar vendimin kontestues të goditur me padi.

Në seancën e datës 25 tetor 2016, palët janë ftuar me rregull, mirëpo e paditura në seancë nuk ka prezentuar, ndërsa mungesën e ka arsyetuar me parashtrësën e datës 25.10.2016. Andaj, gjykata konform nenit 41 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA), seancën e ka mbajtur në mungesë të të paditurës.

Gjykata në seancën e datës 26 tetor 2016 ka bërë administrimin e provave dhe atë: aktvendimi nr. 5052818 i datës 13.08.2014, flete lëshimi nga QKUK nr.147 të datës 29.08.2014 dhe 16.09.2013, raportet mjekësore të datës 13.11.2014, raporti nga H. i datës 04.01.2012, raportet e datës 21.01.2013 04.07.2012, 02.08.2004, 04.12.2014, 22.09.2014, 26.11.2012, 17.11.2012, 13.08.2012, 10.09.2012, 01.11.2010, përgjigja në padi e datës 01.08.2016, vendimi i të paditurës i datës 15.05.2014, certifikata e mjekut e datës 18.03.2014, shqyrtimi i ankesave i datës 30.07.2014, vlerësimi i komisionit mjekësor i datës 28.04.2014, formulari i aplikimit i datës 19.03.2014, raporti specialistik nga KRCT i datës 24.10.2016 si dhe vendimi i datës 07.02.2011.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Nga vendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par.2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti, etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 të po të njëjtit ligj, parashihet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtën dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar, etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se: *“Këshilli i Ankesave me ekspert mjekësor të lëmive përkatëse, duke vepruar sipas ankesës së Sh. N. nga B. B., nr.xxxxxxx të 17.06.2014 në mënyrë të gjithanshme, në seancën e vet të datës 30.07.2014, i ka shqyrtuar shkresat e lëndës, pretendimet ankimore, dokumentacionin mjekësor, që gjendet në lëndë dhe vlerësimin e Komisionit Mjekësor të shkallës së parë të datës 28.04.2014, në përputhje me nenin 2.2 të Ligjit PPAK, dhe ka konstatuar se nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të qenë shfrytëzues i pensionit me aftësi të kufizuara të plotë dhe të përhershme...”*. Po ashtu në arsyetimin e këtij vendimi thuhet se: *“Komisioni me ekspert mjekësor nga shkalla e dytë, në seancën mjekësore, kanë vlerësuar komplet dokumentacionin mjekësor dhe për bazë kanë marrë certifikatën e mjekësisë familjare të licencuar, dokumentacionin mjekësor si dhe raportet nga specialistet dhe është konstatuar se nuk ka sjellë dëshmi të mjaftueshme për të përmbushur kriteret, për të qenë shfrytëzues i pensionit me aftësi të kufizuara të plotë dhe e përhershme, siç përcaktohet me Ligjin 2003/23, konform nenit 3 për persona me aftësi të kufizuara”*, me ç’rast e refuzon ankesën si të papabuar dhe vërteton vendimin e shkallës së parë.

Në bazë të vendimit të lëshuar nga vet e paditura, të datës 07.02.2011, është vlerësuar se paditësja i plotëson kushtet e përcaktuara me Ligjin 2003/23 për zgjedhshmërinë për pensionin e personave me aftësi të kufizuara, me ç’rast i është aprovuar kërkesa për pension për një vit.

Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se organi i padituri, nuk ka bërë fare arsyetim në vendimin e saj, se nga cila bazë paditëses i është rikthyer aftësia e plotë dhe e përhershme, kur nga vet vlerësimet e komisioneve mjekësore të mëparshme është konstatuar se paditësja ka paaftësi të plotë dhe të përhershme andaj nuk është e qartë se si komisioni mjekësor, ka ardhur deri përfundim se gjendja e paditëses ka ndryshuar dhe se ajo nuk ka paaftësi respektivisht se ka pushuar se ekzistuari paaftësia e saj, dhe se ajo nuk i plotëson kushtet ligjore për t'iu njohur e drejta në pension. Lidhur me këtë çështje nuk është dhënë asnjë arsyetim as nga Komisioni Mjekësor e as në aktvendimin e atakuar të së paditurës.

Gjykata si rregull konfliktin administrativ e vendos në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur me padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike, përderisa nga dokumentet mjekësore të prezentuara nga paditësja, rezulton se gjendja shëndetësore e saj është e rëndë dhe e njëjta është e paaftë për punë, ndërsa me aktvendimin e atakuar paditëses i është refuzuar pensioni, pa dhënë detaje apo arsye pse është refuzuar.

Të metat e caktuara më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanojë të metat e cekura, të nxjerrë vendim të drejtë, të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5,6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.67/15, më datë 25 tetor 2016

Procesmbajtësja
Ganimete Hasani Krasniqi

G j y q t a r j a
Arjeta Sadiku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.